Banka e Shqipërisë
Departamenti i Politikës Monetare

Rezultatet e Vrojtimit të Aktivitetit Kreditues
Prill 2009[1]

Rezultatet nga vrojtimi i aktivitetit kreditues tregojnë se kriteret për kreditë dhënë bizneseve dhe individëve, në përgjithësi mbeten të shtrënguara edhe për tremujorin e parë të vitit 2009. Faktorët kryesorë pas politikës shtrënguese të bankave vijojnë të jenë si në vrojtimet e kaluara; vlerësimi për situatën makroekonomike dhe faktorë specifikë të sektorit ku operojnë për bizneset; dhe gjendja financiare për individët. Në ndryshim nga vrojtimi i kaluar, kriteret për miratimin e kredive për bizneset kanë qenë më të shtrënguara se sa kriteret për miratimin e kredive të individëve. Kështu, balanca neto[2] (përqindja neto e bankave që raportojnë lehtësim të kritereve) e ndryshimit të kritereve të kredidhënies sipas opinioneve të ekspertëve të bankave është -66% për ndërmarrjet dhe -44% për individët. Kriteret për miratimin e kredive dhënë bizneseve vijojnë edhe në këtë vrojtim të raportohen më të shtrënguara për korporatat se sa për bizneset e vogla dhe të mesme dhe; për kreditë me qëllim përdorimi për investime afatgjata se sa për qëllime të kapitalit qarkullues. Kriteret për kredinë e individëve janë shtrënguar në të njëjtën shkallë si për blerje banese ashtu edhe për kredinë konsumatore.

Bazuar në opinionet e bankave kërkesa për kredi e ndërmarrjeve dhe e individëve në tremujorin e parë të vitit 2009 është ulur. Kërkesa neto (përqindja neto e bankave që kanë raportuar se kërkesa është rritur) për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme është negative, për herë të parë në këtë tremujor.

Pritjet e bankave për tremujorin e dytë të vitit 2009 flasin për një zbutje të mundshme të standardeve shtrënguese që bankat do të aplikojnë krahasuar me shkallën aktuale të shtrëngimit të tyre, si për ndërmarrjet (balanca neto e pritjeve -22% krahasuar me balancën neto aktuale -66%) ashtu edhe për individët (balanca neto e pritjeve -33% krahasuar me balancën neto aktuale -44%).

---

1 Vrojtimi i realizuar në muajin prill 2009 mbulon zhvillimet në aktivitetin kreditues të ndodhura gjatë tremujorit të parë të vitit 2009 dhe pritjet e bankave për ndryshime të mundshme në aktivitetin kreditues në tremujorin e dytë të vitit 2009. Frekuenca e këtij vrojtimi duke filluar nga viti 2009 do të jetë tremujore (prej vitit 2002 vrojtimi i aktivitetit kreditues është zhvilluar dy herë në vit).

2 Përgjigjet e bankave individuale grumbullohen, peshohen dhe shprehen në formën e balancave neto – diferencë e përgjigjeve të bankave që kanë raportuar lehtësim të kritereve/rritje të kërkesës dhe atyre që kanë raportuar shtrëngim të kritereve/rënie të kërkesës.

Kredia për bizneset

Në vrojtimin e aktivitetit kreditues për tremujorin e parë të vitit 2009, ekspertë të bankave janë shprehur për një shtrëngim të standardeve për kreditë e dhëna bizneseve në një shkallë më të theksuar krahasuar me vrojtimin e mëparshëm. Diferenca neto e bankave që janë shprehur për lehtësim të kritereve është ulur në -66% krahasuar me -56% në vrojtimin e kaluar. Kriteret për kredinë dhënë korporatave dhe për kredinë me qëllim financimin e investimeve kanë qenë më të shtrënguara se sa kriteret për kredinë dhënë bizneseve të vogla e të mesme dhe për kredinë për qëllime financimi të kapitalit qarkullues.

Faktorët me ndikimin më të madh në shtrëngimin e kritereve të kredisë janë gjendja aktuale dhe e pritshme makroekonomike si dhe problemet specifike të sektorit ku operojnë firmat. Gjendja e kredive me probleme është një faktor, rëndësia e të cilit në shtrëngimin e standardeve të miratimit të kredive është rritur në tremujorin e parë të këtij viti.

Grafik 1: Ndryshimet në standardet e kredisë të aplikuara në kreditë e bizneseve dhe ndikimi i faktorëve të ndryshëm në to (balanca neto[1)], në përqindje).



Burimi: Banka e Shqipërisë.
Shënim 1. Balanca pozitive tregon për lehtësim të standardeve ose që faktori ka ndikuar në lehtësimin e standardeve të kredidhënies; ndërsa balanca negative tregon për shtrëngim të standardeve ose që faktori ka ndikuar në shtrëngimin e standardeve të kredidhënies.

Politika shtrënguese e bankave gjatë tremujorit të parë është realizuar nëpërmjet rritjes së marzhit mesatar për kreditë, uljes së madhësisë së kredisë së akorduar dhe rritjes së kërkesës për kolateral në raport me madhësinë e kredisë.

Tabelë 1: Përmbledhje e përgjigjeve të bankave për ecurinë e kritereve të miratimit të kredisë, tremujori i parë, 2009.

	Total	**SME**	**Korporata**	**Kapital qarkullues**	**Investime**
Janë shtrënguar shumë	3 banka	2 banka	3 banka	2 banka	3 banka
Janë shtrënguar disi	5 banka	6 banka	5 banka	5 banka	5 banka
Kryesisht të pandryshuara	2 banka	2 banka	2 banka	3 banka	2 banka

Janë lehtësuar disi	-	-	-	-	-
Janë lehtësuar shumë	-	-	-	-	-
Total	**10**	**10**	**10**	**10**	**10**
Balanca neto*)	**-66%**	**-61%**	**-66%**	**-47%**	**-66%**

Burimi: Banka e Shqipërisë.
**)Shih shënimin 1.*

Kërkesa për kredi. Kërkesa neto e ndërmarrjeve për kredi është vlerësuar në rënie dhe negative për tremujorin e parë të vitit – përqindja neto e bankave që raportojnë rritje të kërkesës është -33%. Kërkesa e korporatave të mëdha është vlerësuar më e ulët se sa kërkesa e bizneseve të vogla dhe të mesme. Gjithashtu, kërkesa për kredi për qëllime investimi është vlerësuar më e ulët se kërkesa për financimin e kapitalit qarkullues. Kërkesa negative e ndërmarrjeve u ndikua, sipas opinioneve të bankave, nga kushtet e kreditimit të aplikuara nga vetë bankat si dhe nga vlerësimi që bizneset kanë për situatën aktuale dhe të pritshme ekonomike. Nga ana tjetër, nevoja për të financuar kapitalin qarkullues është një faktor që dha kontribut pozitiv në kërkesën e bizneseve për kredi.

Grafik 2: Kërkesa e bizneseve për kredi dhe kontributi i faktorëve të zgjedhur (balanca neto[2)], në përqindje).



Burimi: Banka e Shqipërisë.
Shënim 2: Balanca pozitive tregon për rritjen e kërkesës ose që faktori ka ndikuar në rritjen e kërkesës, ndërsa balanca negative tregon për uljen e kërkesës ose që faktori ka ndikuar në uljen e kërkesës për kredi.

Tabelë 2: Përmbledhje e përgjigjeve të bankave për ecurinë e kërkesës së bizneseve për kredi, tremujori i parë, 2009.

	SME	**Korporata**	**Kap.qarkullues**	**Investime**
Dukshëm më e lartë	-	-	-	-
Lehtësisht më e lartë	1 bankë	1 bankë	2 banka	-
Pothuajse njësoj	3 banka	2 banka	3 banka	1 bankë
Lehtësisht më e ulët	5 banka	5 banka	4 banka	7 banka
Dukshëm më e ulët	1 bankë	2 banka	1 bankë	2 banka
Total	**10**	**10**	**10**	**9**
Balanca neto*)	**-27%**	**-29%**	**-25%**	**-52%**

Burimi: Banka e Shqipërisë.
**)*Shih shënimin 2

Pritjet. Bankat presin lehtësim në shkallën e shtrëngimit të kritereve për miratimin e kredive, në tremujorin e dytë të vitit 2009. Për herë të parë gjatë këtij vrojtimi që nga gjashtëmujori i parë i vitit 2007 pritjet dhe vlerësimi për situatën aktuale kanë ndryshime të ndjeshme. Përqindja e bankave që presin lehtësim të kritereve në tremujorin e ardhshëm është rritur në -22% krahasuar me -50% në vrojtimin e kaluar, 44 pikë përqindjeje më e lartë se balanca për situatën aktuale.

Kredia për individë

Opinionet e agreguara të bankave tregojnë për një shtrëngim më të ulët të standardeve të kredidhënies për individët në tremujorin e parë të vitit 2009 krahasuar me vrojtimin e mëparshëm (balanca është rritur në -44% nga -61% në vrojtimin e mëparshëm). Kriteret janë shtrënguar me të njëjtin intensitet si për kredinë konsumatore ashtu edhe për kredinë për blerje banese, balanca neto rreth -44%. Ndërsa për kredinë për banesa nuk ka ndryshime të ndjeshme krahasuar me vrojtimin e kaluar: përqindja neto e bankave që shprehen për lehtësim të kritereve për kredinë konsumatore është rritur me 30 pikë përqindje.

Bankat kanë renditur situatën në tregun e pasurive të paluajtshme, gjendjen financiare të individëve si dhe nivelin aktual ose të pritshëm të likuiditetit të bankës si faktorët kryesorë që kanë ndikuar në kahun shtrëngues të standardeve të kredidhënies gjatë tremujorit të parë të vitit 2009.

Grafik 3: Ndryshimet në standardet e kredisë të aplikuara në kreditë e individëve për banesa dhe për konsum, dhe ndikimi i faktorëve të ndryshëm (balanca neto*), në përqindje).



Burimi: Banka e Shqipërisë.
*) *Shih shënimin 1.*

Politika shtrënguese e bankave gjatë tremujorit të parë të vitit u zbatua nëpërmjet zgjerimit të marzhit mesatar si dhe rritjes së kërkesës për kolateral në raport me madhësinë e kredisë (balanca neto përkatësisht –58% dhe -45%). Në të njëjtin drejtim shtrëngues por, me ritme më të ulëta, ka ndikuar edhe zgjerimi i marzhit për kreditë me rrezik (balanca neto në tremujorin e parë të vitit ra në -46% nga -57% që ishte në gjashtëmujorin e dytë 2008).

Kërkesa për kredi. Kërkesa neto e individëve për kredi sipas opinioneve të ekspertëve të bankave është negative në tremujorin e parë të vitit 2009. Sipas llojit të kredisë, kërkesa për kredi për financimin e banesës shënoi një rënie më të theksuar se sa kredia për kredinë konsumatore.

Faktorët që kanë ndikuar më shumë në rënien e kërkesës për kredi gjatë tremujorit të parë 2009 janë nevoja për financimin e banesës (për herë të parë balanca shënoi vlerë negative -27%), zhvillimet në tregun e pasurive të paluajtshme si dhe kushtet e kreditimit të aplikuara nga banka. Ndërsa përdorimi i burimeve alternative të financimit gjatë tremujorit të parë të vitit ndikoi pozitivisht në kërkesën për kredi nga bankat.

Grafik 4. Kërkesa e individëve për kredi dhe kontributi i faktorëve të zgjedhur (balanca neto[*)], në përqindje.



Burimi: Banka e Shqipërisë.
[*)]*Shih shënimin 2.*

Pritjet. Për tremujorin e dytë të vitit 2009 ekspertët e bankave shprehen për shtrëngim në një shkallë më të ulët të kritereve dhe standardeve të miratimit të kredive për individët (balanca e pritjeve është rreth 10 pikë përqindjeje më e lartë se balanca e situatës aktuale).

Aktiviteti kreditues sipas monedhës.

Pritjet e bankave për aktivitetin kreditues në tremujorin e dytë të vitit 2009 ndryshojnë sipas monedhës me të cilën miratohet kredia. Bazuar në opinione nga ekspertët e bankave, në tremujorin e ardhshëm kredia në lekë do të rritet ndërsa kredia në monedhë të huaj do të ulet.

Krahas pritjeve për zhvillimet në kreditim, bankat kanë vlerësuar sipas rëndësisë faktorët që nxisin bizneset dhe konsumatorët për të kërkuar kredi në valutë. Për sa i përket bizneseve, ekspertë të bankave gjykojnë se burimi i të ardhurave në valutë dhe diferenca në normat e interesit mbeten faktorë të rëndësishëm që shpjegojnë pse bizneset kërkojnë kredi në valutë. Megjithatë ndikimi i këtyre faktorëve në kërkesen në tremujorin e parë të

vitit është ulur. Në ndryshim nga vrojtimet e kaluara, gjatë vrojtimit të rradhës është rritur pesha e faktorit që lidhet me pritjet për kursin e këmbimit. Ndërsa kërkesa e individëve, sipas opinionit të ekspertëve të bankave, është nxitur nga diferenca në normat e interesit dhe nga çmimet e mallrave të blerë, të shprehura në valutë.

Grafik 5. Faktorët që kanë ndikuar kërkesën e bizneseve për kreditim në valutë të huaj.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Bankat presin në përgjithësi norma më të larta të interesit për kreditë që do të akordohen në tremujorin e ardhshëm. Për sa i përket ndarjes së kredisë sipas monedhës me të cilën shprehet, bankat presin norma më të larta të rritjes së normës së kredisë në valutë – përqindja neto e bankave që presin rritje të normës së interesit të kredisë në valutë është +23% krahasuar me përqindjen neto +2%, që presin rritje të normës së interesit të kredisë të shprehur në lekë.

Grafik 5. Faktorët që kanë ndikuar kërkesën e individëve për kreditim në valutë të huaj.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Aneks 1

Kredia për biznese

Në procesin e agregimit të rezultateve, secili opinion është peshuar në bazë të përgjigjes së tij. Për shembull, bankave që janë përgjigjur se standardet janë "shtrënguar shumë" u është dhënë dyfishi i peshës krahasuar me përgjigjet "shtrënguar pak". Rezultatet analizohen duke llogaritur balancën neto si diferencën e balancave të peshuara të bankave, që kanë raportuar lehtësim/rritje të standardeve / kërkesës dhe atyre që kanë raportuar shtrëngim / ulje të standardeve / kërkesës. Balancat neto janë shkallëzuar në mënyrë që të marrin vlera brenda intervalit +/- 100.

	BALANCA NETO			
	2007-II	2008-I	2008-II	2009-T1
Si kanë ndryshuar standardet e miratimit të kredisë?				
- Tremujorin e kaluar	-5.4	-26.2	-53.5	-66.3
- Tremujorin e ardhshëm	-5.7	-17.7	-50.0	-21.0
Faktorët që kanë ndikuar standardet e miratimit të kredisë:				
-Mjaftueshmëria e kapitalit të bankës	-21.9	-4.7	-13.4	-9.3
-Vendime të Bankës së Shqipërisë	6.5	-42.8	-12.9	-10.1
-Konkurrenca në sistemin bankar	-34.5	-9.9	-7.4	-9.3
-Niveli aktual ose i pritshëm i likuiditetit	-	-	-31.1	-37.4
-Probleme specifike të sektorit ku vepron biznesi	26.5	-48.7	-62.8	-84.3
-Situata aktuale ose e pritshme makroekonomike	16.3	-53.7	-84.3	-83.8
-Kreditë me probleme	24.1	-30.9	-48.3	-60.4
Si kanë ndryshuar kushtet e miratimit të kredisë?				
-Marzhi mesatar	-	30.0	-59.9	-54.0
-Marzhi për kreditë me rrezik	-	-19.0	-75.5	-45.7
-Komisionet	-	6.0	-12.3	-10.1
-Madhësia e kredisë	-	9.0	-17.0	-32.7
-Kërkesa për kolateral/në raport me madhësinë e kredisë	-	-2.0	-40.2	-27.2
-Maturiteti maksimal i kredisë	-	2.0	-42.8	-56.9
Si ka ndryshuar kërkesa e bizneseve për kredi?				
-SME gjashtëmujorin e kaluar	56.9	25.0	4.8	-26.7
-SME gjashtëmujorin e ardhshëm	72.9	29.0	-23.8	-19.0
-Korporata gjashtëmujorin e kaluar	64.0	50.0	-2.0	-29.1
-Korporata gjashtëmujorin e ardhshëm	54.2	21.0	-23.8	-28.7
Faktorët që kanë ndikuar ndryshimin e kërkesës për kredi:				
-Nevoja për financimin e inventarëve	44.3	51.0	38.9	13.6
-Nevoja për financimin e investimeve fikse	39.6	42.0	-11.6	-10.9
-Përdorimi i burimeve të financimit alternative	16.2	-15.0	-1.5	-2.0
-Vendimet e politikës monetare të Bankës së Shqipërisë	-2.9	10.0	-17.9	-12.0
-Kushtet e kreditimit të aplikuara nga banka juaj	12.3	10.0	-22.4	-28.2
-Situata aktuale ose e pritshme makroekonomike	18.9	14.0	-16.1	-45.8
Arsyet e kreditimit në valutë të huaj:		49.0		
-Burimi i të ardhurave në valutë të huaj	-	99.0	68.0	49.4
-Diferenca në normat e interesit	-	42.0	92.0	81.5
-Shpenzime në valutë të huaj	-	13.0	54.0	42.8
-Gjendja e likuiditetit të bankës tuaj	-	28.0	50.0	35.7
-Pritjet për kursin e këmbimit	-	25.0	29.0	51.0

-Pritjet për normat e interesit të referencës	-	65.0	40.0	34.5
-Ndërgjegjësim i ulët për zhvillimet ekonomike	-		57.0	24.8

Aneks 2

Kredia për individë

Në procesin e agregimit të rezultateve, secili opinion është peshuar në bazë të përgjigjes së tij. Për shembull, bankave që janë përgjigjur se standardet janë "shtrënguar shumë" u është dhënë dyfishi i peshës krahasuar me përgjigjet "shtrënguar pak". Rezultatet analizohen duke llogaritur balancën neto si diferencën e balancave të peshuara të bankave, që kanë raportuar lehtësim/rritje të standardeve / kërkesës dhe atyre që kanë raportuar shtrëngim / rënie të procedurave / kërkesës. Balancat neto janë shkallëzuar në mënyrë që të marrin vlera brenda intervalit +/- 100.

	2007-II	2008-I	2008-II	2009-T1
Si kanë ndryshuar standardet e miratimit të kredisë?				
- Tremujorin e kaluar	-5.3	-26.2	-62.3	-43.6
- Tremujorin e ardhshëm	-10.5	-5.5	-27.3	-33.5
Faktorët që kanë ndikuar standardet e miratimit të kredisë:				
-Mjaftueshmëria e kapitalit të bankës	-31.2	7.1	-26.2	-14.2
-Vendime të Bankës së Shqipërisë	-0.1	-35.9	-17.0	-9.9
-Konkurrenca e sistemit bankar	-22.7	-6.3	2.2	-9.3
-Niveli aktual ose i pritshëm i likuiditetit	-19.3	12.4	-35.7	-42.1
-Gjendja financiare e individëve	-29.1	-47.7	-53.3	-58.3
-Kreditë me probleme	-5.7	-51.6	-40.9	-29.8
-Zhvillimet në tregun e pasurive të paluajtshme	-10.7	-18.0	-31.7	-60.2
Si kanë ndryshuar kushtet e miratimit të kredisë?				
-Marzhi mesatar	-	6.0	-37.7	-57.9
-Marzhi për kreditë me rrezik	-	-21.0	-57.4	-46.1
-Komisionet	-	-2.0	-10.4	-11.7
-Madhësia e kredisë	-	-6.0	-37.5	-32.4
-Kërkesa për kolateral/në raport me madhësinë e kredisë	-	-1.0	-30.1	-44.7
-Maturiteti maksimal i kredisë	-	-3.0	-20.3	-20.9
Si ka ndryshuar kërkesa e individëve për kredi?				
-Kredi për shtëpi	67.7	25.3	-29.3	-53.1
-Kredi për konsum	61.8	22.8	-26.9	-40.4
Faktorët që kanë ndikuar ndryshimin e kërkesës për kredi:				
-Nevoja e individëve për financimin blerjes së shtëpisë	64.8	50.9	22.4	-27.1
-Nevoja e individëve për financimin konsumit	59.8	50.7	33.3	14.2
-Përdorimi i burimeve të financimit alternative	-	-24.6	-23.3	10.2
-Vendimet e politikës monetare të Bankës së Shqipërisë	7.1	-5.6	5.5	-8.6
-Besimi i konsumatorëve	16.3	21.1	-10.3	-21.3
-Zhvillimet në tregun e pasurive të paluajtshme	3.6	19.6	-27.3	-54.5
-Kushtet e kreditimit të aplikuara nga banka juaj	-	32.3	0.5	-28.3
Arsyet e kreditimit në valutë të huaj:				
-Burimi i të ardhurave në valutë të huaj	-	52.1	57.1	42.0
-Çmimet e të mirave të blera të shprehura në valutë të huaj	-	76.7	77.4	58.6
-Diferenca në normat e interesit	-	87.5	79.9	82.2
-Gjendja e likuiditetit në valutë të bankës tuaj	-	34.8	49.5	39.5

-Pritjet për kursin e këmbimit	-	37.7	27.0	28.0
-Pritjet për normat e interesit të referencës	-	41.7	23.3	24.4
-Ndërgjegjësim i ulët për zhvillimet ekonomike	-	54.4	40.7	37.7